

KONTRATË

SHIT-BLERJE TË PJESËVE TË KAPITALIT THEMELTAR TË SHOQËRISË "LEGA SPORT" SH.P.K

Në Tiranë, sot më datën 11/07/ 2018, në selinë e shoqërisë "LEGA SPORT" sh.p.k., palët e mëposhtme kontraktuese, redaktuan kontratën për shitjen e pjesëve të kapitalit themeltar të shoqërisë "LEGA SPORT" sh.p.k., si më poshtë:

PALËT

z. **KEJDI TOMORRI**, i biri i Yllit, lindur më 20/04/1980, në Tirane dhe banues në Tiranë, identifikuar me kartë identiteti me nr. ID Nr.I00420217L, zotërues i 34,00 pjesë të kapitalit themeltar në shoqërinë "LEGA SPORT" sh.p.k. person juridik, shoqëri e cila është krijuar dhe funksionon konform legjislacionit shqiptar, themeluar dhe regjistruar si person juridik shqiptar në Regjistrin Tregtar më datë 01/01/2003, me NIUS K31403245N,

Që këtu e mëposhtë në këtë kontratë do të quhet "SHITËSI"

DHE

z. **YLLI TOMORRI**, i biri i Skenderit, lindur më 04/11/1950, në Tirane dhe banues në Tiranë, identifikuar me kartë identiteti me nr. ID Nr F01104040M, zotërues i 33,00 pjesë të kapitalit themeltar në shoqërinë "LEGA SPORT" sh.p.k. person juridik, shoqëri e cila është krijuar dhe funksionon konform legjislacionit shqiptar, themeluar dhe regjistruar si person juridik shqiptar në Regjistrin Tregtar më datë 01/01/2003, me NIUS K31403245N


Që këtu e mëposhtë në këtë kontratë do të quhet "BLERËSI"

BAZA LIGJORE

Kjo kontratë hartohet në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 9901 i datës 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare" dhe Ligjit nr. 7850 , datë 29.07.1997 "Kodi Civil", i azhornuar.

OBJEKTI I KONTRATËS

Objekti i kësaj kontrate është transferimi me anë të shitjes i 34.00 % të pjesëve të Kapitalit Themeltar të shoqërisë "LEGA SPORT" sh.p.k., të zotëruara nga Ortaku, z. Kejdi Tomorri, në favor të z. Ylli Tomorri.



Shoqëria "LEGA SPORT" sh.p.k., është regjistruar si person juridik shqiptar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më datë 01/01/2003, me NIUS K31603245N, me seli Njesia Bashkiake Nr.10, Rruga e KAVAJES, Pallati Nr.12 në Tiranë dhe me kapital themeltar në vlerën 100.000,00 Lekë, i përbërë nga 3 (tre) kuota.

Shoqëria "LEGA SPORT" sh.p.k është e përbërë nga Ortakët:

1. **z. Kejdi Tomorri**, zotërues i 34,00 pjesë të kapitalit themeltar; me vlere 34.000 Leke;
2. **z. Ylli Tomorri**, zotërues i 33,00 pjesë të kapitalit themeltar me vlere 33.000 Leke
3. **z. Fatmir Hajdini**, zotërues i 33,00 pjesë të kapitalit themeltar; , me vlere 33.000 Leke;

Në bazë të Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë "LEGA SPORT" sh.p.k., date 25/06/.2018 është miratuar transferimi me anë të shitjes të pjesëve të kapitalit themeltar, të zotëruara nga ortaku z.Kejdi Tomorri, në favor të z. Ylli Tomorri, si më poshtë vijon:

- Transferimi i 34.00 pjesëve të kapitalit me vlere 34.000 Leke, të zotëruara nga ortaku z. Kejdi Tomorri në favor te z.YLLI TOMORRI,

Personi i mësipërme, palë në këtë kontratë, me vullnetin e tij të plotë dhe të lirë, i cili në vazhdim të kësaj kontrate do të quhet shkurt "SHITËSI" dhe "BLERËSI" kanë lidhur realisht kontratën e shitjes me kushtet e mëposhtme:

Shitësi, z.Kejdi Tomorri, ortak i shoqërisë "LEGA SPORT" sh.p.k., zotërues i 34.00 të pjesëve të kapitalit themeltar me vlere 34.000 Leke, të kësaj shoqërie, i cili ia shet z. Ylli Tomorri

Blerësi z. Ylli Tomorri ka vendosur të blej 34,00 pjesë të kapitalit themeltar me vlere 34.000 Leke të shoqërisë "LEGA SPORT" sh.p.k., që zotërohet nga ortaku z. Kejdi Tomorri zotërues i 34.00 të pjesëve të kapitalit themeltar të kësaj shoqërie.


Me nënshkrimin e kësaj kontrate, depozitim e saj dhe të akteve që lidhen me këtë transferim të pjesëve të kapitalit themeltar të shoqërisë në QKB, shitësi, z. Kejdi Tomorri zhvishet nga cdo e drejtë pronësie mbi pjesët e kapitalit themeltar të shoqërisë "LEGA SPORT" sh.p.k., objekt i kësaj kontrate dhe zotërues i tyre bëhet blerësi z. YLLI TOMORRI zotërues i 33.00 të pjesëve të kapitalit themeltar.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, z. Kejdi Tomorri nuk ka asnjë pretendim financiar kundrejt blerësit.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, shoqëria "LEGA SPORT" sh.p.k përbëhet nga ortakët:

z.YLLI TOMORRI, me pjesemarrje ne kapitalin themeltar ne përqindje 67% dhe me vlere 67.000 Leke

z.FATMIR HAJDINI me pjesmarrje ne kapitalin themeltar ne perqindje 33% . me vlere 33.000 Leke



Kjo kontratë hyn në fuqi menjëherë me nënshkrimin e saj nga palët, të cilët nuk mund të ndryshojnë kushtet e vendosura në të me pëlqimin e tyre.

Cdo mosmarrëveshje mes tyre palët angazhohen se do t'i zgjidhin me mirëkuptim dhe në rast se kjo nuk arrihet, kompetente për gjykimin e konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kjo kontratë hartohet në gjuhën shqipe në katër kopje të barazvlefshme. Palët marrin nga një kopje, një kopje mbetet në zyrën e noterit dhe kopja e katërt do të depozitohet në QKB.

Ngarkohet zj. Ermira Tomorri, e bija e Zihni, i datëlindjes 18/10/1953/, identifikuar me kartë identiteti nr.personal F36018062H të depozitojë këtë kontratë pranë QKB si edhe të kryej cdo veprim të nevojshëm lidhur me këtë proces.

Kontrata pasi u lexua nga palët, me zë të lartë dhe të qartë, dhe pasi dispozitat u gjetën në përputhje të plotë me vullnetin e tyre të lirë e nënshkruan atë pa vërejtje.

SHITËSI

z. Kejdi Tomorri


Kejdi Tomorri



BLERËSI

z. Ylli Tomorri

YLLI TOMORRI



LEGA SPORT Shpk
K31603245N
Tiranë